



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria
Vlada-Government
Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Ministarstvo Ekonomskog Razvoja-Ministry of Economic Development

Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme /Departman za Finansije i Opšte Usluge /Department of Finance and General Services

Ministria e Zhvillimit Ekonomik shpallë **KONKURS PËR AVANCIM** të nëpunësve civilë për këtë vend të punës:

Njësia për Politika dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike
Vendi i punës: Zyrtar i Lartë për Komunikim me Publikun - IN/020
Numri i Konkursit: APF0005448
Koeficienti : 8.00
Kohëzgjatja e Emërimit: Pa afat të caktuar
Mbikëqyrësi: Udhëheqësi i NJPMNP

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Harton planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave dhe jep rekomandime lidhur me realizimin objektivave;
- Përgatit, komunikata dhe përgjigjet nga pyetjet e gazetarëve dhe parlamentarëve të Kuvendit të Kosovës drejtuar Ministrit të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik që kanë të bëjnë me Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike;
- Koordinon punën me pjesët tjera të institucionit dhe komunikon, sipas nevojës, me zyrtarët e informimit të NP;
- Merr pjesë dhe kontribuon në të gjitha konferencat për shtyp të Ministrisë e që kanë të bëjnë me NP gjegjëse;
- Përgatit raportet periodike lidhur me kërkesat për Qasje në Dokumentet Publike drejtuar Ndërmarrjeve Publike;
- Mirëmban web faqen e NJPMNP-së;
- Monitorimi i mediave për veprimtarin e NP-ve

- Bashkëpunimi me zyrtaret e informimit të Ndërmarrjeve Publike Qendrore në komunikim me mediat

Kualifikimi i nevojshëm :

- Diploma universitare, fakulteti i gazetarisë ose në ndonjë fushë të përafërt, 3 vite përvojë pune profesionale.
- Njohuri dhe përvojë në fushën e gazetarisë dhe komunikimit publik, shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave, aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Internetit)
- Njohuri të mira të gjuhës angleze, e dëshirueshme

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT PER AVANCIM

Procedura e konkurrimit është e hapur për nëpunës civil ekzistues në MZHE, te cilët i plotësojnë kriteret e konkursit për avancim. MZHE ofron mundësi të barabarta të avancimit për të gjithë nëpunësit civil ekzistues brenda MZHE-së. Rekrutimi dhe përzgjedhja do të bëhet në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe Rregulloren Nr. 21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civilë.

Kërkesa për punësim dhe përshkrimi i punës mund të merret në recepcionin e ndërtesës së Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (Sheshi Nëna Terezë, Toskanë, Prishtinë) Formularin zyrtar për aplikim, mund ta gjeni edhe në Web faqen <http://mzhe.rks-gov.net>

Së bashku me formularin zyrtar të punësimit duhet të dorëzohet dëshmia për kualifikim shkollor, kurset e ndjekura, dëshmitë për përvojën e punës, dy vlerësimet e fundit të punës si dhe dy referenca. Përdorimi i formularit të gabueshëm dhe ai i pakompletuar me të dhënat e kërkuara do të konsiderohet i pavlefshëm.

Kërkesat dorëzohen në Zyrën e Arkivës, kati I-rë, ndërtesa e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik ose me postë.

Afati i konkurrimit është prej datës 03/06/2019 deri me datë 10/06/2019, deri në orën 16:00.

Konkursi është i hapur 8 ditë nga dita e publikimit.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit të konkurrimit nuk do të pranohen.

Për informata shtesë, ju lutemi telefononi në numrat: 038 200 21524.